



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 409/5 prot.

Elbasan, me 20.03.2025

VENDIM

Nr. 11, datë 20.03.2025

Për

pagesën e orës mësimore të personelit akademik të ftuar (në cilësinë e personaliteteve akademike)

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL", Vendimit të Senatit Akademik nr. 33, datë 17.03.2025, "Për pagesën e orës mësimore të personelit akademik të ftuar (në cilësinë e personaliteteve akademike)", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Pagesën e personelit akademik të ftuar (në cilësinë e personaliteteve akademike) me 5 fishin e pagesës orare të titullit apo gradës për orët mësimore të zhvilluara.
 2. Fondi për këtë pagesë të përballohet nga granti i parashikuar për shpenzimet e pagave të punonjësve.
 3. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT

Dr. Ardian Durmishi

